

7 Djemtë e Efesit. Transferimi i lipsanit të Oshënares Evdhokia. 9000 dëshmorët në Persi



E hënë, 4 gusht 2025 – Shenjtori i ditës.

JEMI NË KRESHMËN E HYJLINDËSES MARI (1 – 15 gusht)

7 Djemtë e Efesit. Transferimi i lipsanit të Oshënares Evdhokia. 9000 dëshmorët në Persi.

– 7 DJEMTË E EFESIT –

Festa e tyre kremtohet edhe në 22 tetor. Quhen: Maksimilian (ose Maksimian), Jamvlik, Martinian, Dionis, Antonin (ose Joan), Konstandin dhe Eksakustodian. U kapën në Efes (brigjet perëndimore të Azisë së Vogël), në kohën e perandorit Deci (249-251), i cili u bëri presion që të bëheshin idhujtarë. Ata i kërkuan një afat për të vendosur, dhe parapëlqyen që të mbylleshin e të vdisnin në një shpellë, pasi më parë ua ndanë pasurinë e tyre të varfërve. Kur Deci e mori vesh këtë gjë, urdhëroi të mbyllnin hyrjen e shpellës me gurë.

Pas rreth 200 vjetësh, në kohën e mbretit shën Theodhosi II (29 korrik), u përhap një herezi që hidhte poshtë ngjalljen e të vdekurve. Në Kishë u krijua konfuzion, kështu që monarku i lutej Perëndisë që të tregonte dogmën e vërtetë. Prandaj, ndërsa ndërtohej një vathë, përdorën edhe gurët e shpellës, pa i ndier, mesa duket, “banuesit” e saj. Atëherë u ngjallën që të shtatë si nga gjumi i një nate të vetme, madje as rrobat nuk u ishin prishur!

Meqenëse kishin uri, dërguan Jamvlikun për të blerë bukë. Duke u ruajtur, ndoshta për shkak të persekutimit siç mendonte, hyri në qytet, të cilin e gjeti të krishterë, e për më tepër, të çoroditur! Habinë e tij e përforcuan shitësit e bukës, të cilët duke parë monedhat e tij të vjetra, e kërcënuan se do ta denonconin nëse nuk do të ndanin së bashku thesarin, që gjoja kishte zbuluar. Ai u frikësua se mos e çonin te Deci. Por ata e çuan te nënkonsulli, i cili e mori për një mashtrues të rastit me ato “gënjeshttrat” trashanike që radhiste.

Bashkëbisedimin e tyre e ndërpreu episkop Marini i Efesit (v. 408 deri ndoshta në v. 431), i cili dëgjoi dhe dyshoi se ishte fjala për mrekulli. Jamvliku i çoi në shpellë dhe çështja u sqarua! Të gjithë, të mahnitur, iu falën shenjtorëve dhe lajmëruan edhe perandorin, i cili vrapoi dhe iu fal edhe ai. Ashtu siç ishin duke biseduar, të rinjve u erdhi gjumë dhe dhanë shpirt. Shenja e përmbinatyrshme e bindi fuqimisht për ngjalljen e të vdekurve. Gjatë natës Theodhosi i pa në ëndërr sikur i kërkuan që t'i varroste aty, në “dhomën e gjumit”, shumëvjeçare. Dhe kjo dëshirë e tyre e fundit u respektua.

* * * * *

- TRANSFERIMI I LIPSANIT TË OSHËNARES EVDHOKIA -

Shën Evdhokia ishte me origjinë nga Azia e Vogël, ku u kap robinjë nga persët, që e çuan në atdheun e tyre. Ajo kishte njohuri të thella për Shkrimet e Shenjta, mësoi në besimin e vërtetë shoqet e saj të robërisë dhe u bë mikja e shumë grave perse, që falë saj njohën Perëndinë. Për këtë, e arrestuan dhe e çuan për ta gjykuar; e rrahën me kamxhik me deje bualli dhe e futën në burg. Pas dy muajsh, doli përsëri para gjykatës dhe pohoi me trimëri Krishtin, Perëndinë e vërtetë. E rrahën me degë trëndafilash plot gjemba, derisa i ranë mishrat përdhe. E futën sërish në burg, ku qëndroi gjashtë muaj, dhe doli për herë të tretë para gjykatës, pa treguar kurrfarë shenje dobësie.

Idhujtarët e zhveshën lakuriq dhe i shtrënguan aq fort në trup degë trëndafilash me gjemba, të gjata sipas shtatit të saj, saqë ato i hynë brenda në mish. Pastaj i hoqën një e nga një dhe copa lëkure binin bashkë me gjembat, duke i shkaktuar shenjtores dhimbje të padurueshme. Pas kësaj e ngjitën në një shtyllë me anë të litarëve, që e mbajtën të lidhur fort atje, derisa i thyen kockat. Në fund, atletes së Krishtit, që ishte gjysmë e vdekur dhe që me zor merrte frymë, xhelatët i prenë kokën, duke i dhënë kështu kurorën e pavyshkur të martires.



[Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë](#)